


Për :	Zyrën e Rregullatorit të Energjisë
Nga:	Valdete Marevci-Dërmaku- Koordinator e Ndërmarrjes me institucione tjera
Përmes:	Arsim Fetahu – Kryeshef Ekzekutiv
Data:	<u>15.09.2020</u>
Subjekti :	Raportimi Rregullativ i N.P "Termokos" Sh.A. në kuadër të shqyrtimit tarifar për sezonin ngrohës 2020/2021



Në lidhje me shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për sezonin 2020/2021, ju përcjellim të bashkangjitura këto raporte :

1. Pasqyrat Rregullative me të dhënat e parashikuara për periudhën (15 tetor 2020 – 15 tetor 2021),
2. Shpalosja e Pasqyrës B,
3. Raportet me të dhëna të detajuara, të kërkuara për shqyrtimin tarifar për sezonin 2020/2021, të cilat përmbajnë:
 - a. Planifikimi i prodhimit të energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B dhe në ngrohtoren qendrore të NP "Termokos" SH.A,
 - b. Planifikimi i sasisë së energjisë së liferuar te konsumatorët dhe humbjet e energjisë ,
 - c. Të dhëna të përmbledhura nga Baza e të dhënave të konsumatorëve,
 - d. Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik ,
 - e. Planifikimi i kyçjeve të reja,
 - f. Planifikimi i investimeve me vetfinansim dhe nga donacionet.
4. Përgjigjet në komentet e dhëna nga ZRRE, në Aplikacionin për tarifa për sezonin 2020/2021.
5. Dokumentet mbështetëse lidhur me Ndërtimin e Objektivit të ri Administrativ:
 - a. Kontratë për studim fizibiliteti (Vlerësim) i situacionit dhe objekteve të NP "Termokos" sh.a, (është dërguar me e-mail),
 - b. Kontratën për Shërbime projektimi (Hartimi i Projektit Detal dhe Vlerësimi i situacionit dhe objekteve të NP "Termokos" sh.a) -(është dërguar me e-mail),
 - c. Lejen Mjedisore Komunale-(është dërguar me e-mail),
 - d. Leja e Ndërtimit-(është dërguar me e-mail),
 - e. Foto sipas Projektit të Objektivit të ri Administrativ-(është dërguar me e-mail).


 Nr. 562/2020-120
 Data: 15.09.20



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

NDËRMARRJA PUBLIKE-PUBLIC ENTERPRISE-JAVNO PREDUZEĆE
"TERMOKOS" SH.A.
J.S.C.
PRISHTINE-PRISHTINA-PRISTINA D.D.

Nr. 1330 dt. 15.09 2020

Raportimi Rregullativ I Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore

Shtojca Nr.1

PASQYRAT (DEKLARATAT) RREGULLATIVE

Planifikimet - Sezona 2020/2021



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Raportimi Rregullativ - Planifikimi për Sezonin 2020/2021

Ndërmarrja:

N.P."Termokos"Sh.A

Periudha:

Tetor/2020-Tetor/2021

Pasqyra A - G1, G2 : Pasqyra e Aseteve Operative

Në Euro

	Asetet Drejtëpërdrejt të Përcaktuara		Asetet Mbështetëse	Asetet e përbashkëta	Totali i Aseteve
	Prodhimi i ngrohjes	Distribucioni dhe furnizimi i ngrohjes			
	a	b	c	d	e
1	Çmimi i blerjes me koston historike	4,369,063.82	47,539,176.92	2,406,225.22	54,314,465.96
2	Zhvlerësimi i akumuluar	-4,276,131.26	-16,747,587.23	-617,254.38	-21,640,972.87
3	Vlera sipas librave kontabël	92,932.56	30,791,589.69	0.00	32,673,493.09
4	Çmimi zavendësues në vlerën e tregut				0.00

Aprovuar nga:	Punuar nga:
EMËRI e MBIEMËRI / Pozita	EMËRI e MBIEMËRI / Pozita
Ismail Kokaj -ZKFTH	
Nënshkrimi:	Nënshkrimi:
Arsim Fetahu- Kryeshef Ekzekutiv	
Data:04.09.2020	Data:04.09.2020



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Raportimi Rregullativ - Planifikimi për Sezonin 2020/2021

Ndërmarrja: **N.P"Termokos"sh.a**

Periudha: **Tetor/2020-Tetor/2021**

Pasqyra B - G1, G2 : Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Në Euro

		Drejtëpërdrejt të Përcaktuara		Mbështetës e	Të Përbashkëta	Total
		Prodhimi i Ngrohjes	Distribuimi dhe Furnizimi i ngrohjes			
	a	c	d	e	f	g
1	Të Ardhurat e lejuara					
2	Të ardhurat nga shitja e ngrohjes				7,259,884.30	7,259,884.30
3	Të ardhurat tjera të lejuara				94,500.00	94,500.00
4	Totali i të ardhurave të lejuara				7,354,384.30	7,354,384.30
5	Shpenzimet e lejuara					
6	Shpenzimet Operacionale					
	Shpenzimet variabile :					
7	Energjia termike nga kogjenerimi				1,203,844.80	1,203,844.80
8	Karburanti				320,500.00	320,500.00
9	Uji i trajtuar				94,697.73	94,697.73
10	Kemikalet për trajtimin e ujit				15,221.62	15,221.62
11	Elektriciteti				596,489.15	596,489.15
12	Shpenzimet e Personelit (puna direkte ne prodhim)				978,038.48	978,038.48
13	Shpenzimet tjera variabile				0.00	0.00
14	Totali i shpenzimeve variabile				3,208,791.77	3,208,791.77
15	Shpenzimet fikse					
16	Riparimet dhe mirëmbajtja				167,600.00	167,600.00
17	Materialet dhe shërbimet				116,000.00	116,000.00
18	Shpenzimet për administratë				111,090.00	111,090.00
19	Shpenzimet e personelit				1,174,449.98	1,174,449.98
20	Shpenzimet e Shitjes dhe tjera Administrative				1,022,156.20	1,022,156.20
21	Totali i shpenzimeve fikse				2,591,296.17	2,591,296.17
22	Totali i shpenzimeve operative				5,800,087.94	5,800,087.94
23	Zhvlerësimi				2,945,156.00	2,945,156.00
24	Totali (Shpenz. operative + Zhvlerësimi)				8,745,243.94	8,745,243.94

Aprovuar nga:	Punuar nga:
EMRI e MBIEMRI / Pozita	EMRI e MBIEMRI / Pozita
Ismail Kokaj - ZKFTH	M. Azemi - MKFTH
Nënshkrimi:	Nënshkrimi:
Arsim Fetahu- Kryeshf Ekzekutiv	
Nënshkrimi:	
Data: 09.09.2020	Data: 09.09.2020





ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Planifikimi për Sezonin 2020/2021

Ndërmarrja **N.P"Termokos"sh.a**

Periudha:

Tetor 2020/Prill 2021

Pasqyra C-G2 : Pasqyra e Faturimit dhe Arkëtimit të Pagesave

Faturimi me matje - sipas konsumit të matur						
	Sip. Ngrohëse [m2]	Kapac. Termik [kW]	Kons. i En. Term. [MWh]	Faturimi për kapac. [EUR]	Faturimi për energji [EURO]	Total faturimi [EURO]
1	413,986.80	471,668.21	54,301.54	367,901.20	1,968,430.83	2,336,332.03
						2,250,000.00
						96.3048048
						86.332.03
						3.69519524

Faturimi pa matje - sipas sipërfaqjes ngrohëse						
	Grupi i konsumatorëve	Sipërfaqja Ngrohëse [m2]	Faturuar [Euro]	Arkëtuar [Euro]	Shkalla e Arkët. [%]	Borgji [Euro]
2	Shtëpiak (Amvisri)	831,842.36	3,413,881.05	2,800,000.00	82.02	613,881.05
3	Komercial dhe Institucional	173,620.12	890,671.22	650,000.00	72.98	240,671.22
4	Total	1,005,462.48	4,304,552.27	3,450,000.00	80.15	854,552.27
						17.98
						27.02
						19.85

5	Total (me matje + pa matje) [EURO]	1,419,449.28	6,640,884.30	5,700,000.00	85.8319426	940,884.30
						14.1680574

Aprovuar nga:	Punuar nga:
EMËRI, MBIEMËRI/Pozita	EMËRI, MBIEMËRI/Pozita
Arsim Fetahu- Kryeshef Ekzekutiv	Arif Ahmeti - Drejtor i Furnizimit
NENSHKRIMI	NENSHKRIMI
Data: 04.09.2020	Data: 04.09.2020

[Signature]





ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Raportimi Rregullativ - Planifikimi për Sezonin 2020/2021

Ndërmarrja

N.P"Termokos"Sh.A

Periudha:

(tetor 2020 - tetor 2021)

Pasqyra D-G1, G2-Pasqyra e shpenzimeve të investimit -aktuale dhe e planifikuar

Në euro

	a	Aktuale -viti 0 (tetor 2020 - tetor2021)	Planifikuar - viti 1 2022	Planifikuar - viti 2 2023	Planifikuar - viti 3 2024	Planifikuar - viti 4 2025
1	Prodhimi i ngrohjes	257,000.00	400,000.00	450,000.00	460,000.00	470,000.00
2	Distribuidi dhe furnizimi me ngrohje	630,000.00	690,000.00	420,000.00	430,000.00	450,000.00
3	Tjera -Administrata dhe Investimet e përbashkëta për të gjitha departamentet	1,395,000.00	110,000.00	125,000.00	150,000.00	160,000.00
4	Totali i investimeve me vetëfinansim	2,282,000.00	1,200,000.00	995,000.00	1,040,000.00	1,080,000.00
5	Donacionet	7,000,000.00	10,000,000.00	11,900,000.00	12,500,000.00	12,500,000.00
6	Grand Total	9,282,000.00	11,200,000.00	12,895,000.00	13,540,000.00	13,580,000.00

Sqarimet lidhur me investimet e planifikuara (viti 0), janë dhënë në dokumentin "Draft Raportet për shqyrtimin tarifor për sezonin 2020/2021".

Aprovuar nga :

EMËRI, MBIEMËRI/Pozita
Arsim Fetahu- Kryeshef Ekzekutiv

Punuar nga:

EMËRI, MBIEMËRI/Pozita
Naim Buxtyçi- Drejtor i Distributimit
Nënshtetues: Naim Buxtyçi

Gani Kelmendi-Drejtor i Prodhimit
Nënshtetues: Gani Kelmendi

Data:09.09.2020

Data:09.09.2020





Raportimi Rregullativ - Planifikimi për Sezonin 2020/2021

Ndërmarrja:

N.P"Termokos"Sh.A

Periudha:

tetor 2020- prill 2021

Pasqyra E - G1, G2 - Pasqyra Teknike

Të dhënat e përgjithshme teknike			
1	Kapaciteti i instaluar i energjisë termike (ngrohjes) në ngrohore	MW	135.60
2	Kapaciteti i instaluar i energjisë termike nga kogjenerimi	MW	140.00
3	Kapaciteti i disponueshëm i energjisë termike (ngrohjes) në ngrohore	MW	134.00
4	Kapaciteti i disponueshëm i energjisë termike (ngrohjes) nga kogjenerimi	MW	140.00
5	Gjatësia e rrjetit të transportit të en.term.KEK-Termokos	km	12.00
6	Gjatësia e rrjetit të distribuimit	km	84.00
7	Numri i nënstacioneve	-	481.00
8	Numri i nënstacioneve aktive	-	464.00

Bilanci i energjisë termike /Prodhimi/			
6	Energjia e futur nga karburanti	MWh	8,023.00
7	Prodhimi bruto i ngrohjes në ngrohore	MWh	7,220.70
8	Sasia e energjisë termike nga kogjenerimi	MWh	267,648.00
9	Humbjet në rrjetin e transportit	MWh	5,352.96
10	Konsumi vetanak	MWh	787.00
11	Prodhimi neto i energjisë termike (ngrohjes)	MWh	268,728.74
12	Efikasiteti total i energjisë termike	%	97
13	Konsumi i ujit	m3	65,823.45
14	Konsumi i elektricitetit	MWh	8,675.36

Bilanci i energjisë termike /shpërndarja e furnizimi/			
13	Sasia e ngrohjes e futur në rrjetin e distribuimit (e matur)	MWh	268,728.74
14	Furnizimi i konsumatorëve me ngrohje (e matur)	MWh	239,279.86
15	Humbjet e distribuimit	MWh	22,230.05
16	Humbjet e distribuimit në përqindje	%	8.3

Të dhënat për konsumatorë			Konsumatorët Shtëpijak	Konsumatorët Komerical dhe Institucional	Totali / Mesatare
17	Kapaciteti i kontraktuar i ngrohjes	MW	83,184.236	70,512.830	153,697,066
18	Totali i sipërfaqes së ngrohur	m2	831,842.36	587,606.92	1,419,449.28
19	Kërkesa specifike për kapacitetin e ngrohjes	W/m2	100.00	120.00	110
20	Orët e ngarkesës së plotë	h	1,500.00	1,500.00	1500
21	Kërkesa për ngrohje (furnizimi me ngrohje i kalkuluar)	MWh	124,776.35	105,769.25	230,545.60

Konsumi i karburantit		Sasia tona	Vlera (LHV) MWh/t	Energjia në karburant MWh
22	Nafta e rëndë (mazuti)	710.00	11.30	8,023.00
23	Nafta e lehtë (diesel D2)			0.00

Sqarim: Humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes janë planifikuar të jenë 8.5 %, por parashikimi i energjisë termike nga karburanti , në këtë tabelë ndikon në zvogëlimin e humbjeve në 8.3%.

Aprovuar nga :	Punuar nga:
EMRI e MBIEMRI / Pozita	EMRI e MBIEMRI / Pozita
Arsim Fetahu- Kryeshef Ekzekutiv	Naim Bytyci- Drejtor i Distribuimit
Nënshkrimi:	Nënshkrimi:
	Raif Vitija- Drejtor i Furnizimit
	Nënshkrimi:
	Gani Kelmendi- Drejtor i Prodhimit
	Nënshkrimi:
Data: 09.09.2020	Data: 09.09.2020



Planifikimi- Sezoni 2020/2021

Vdërmarrja: **Termokos Sh.a**

Periodha: **Tetor 2020-Tetor 2021**

Pasqyra B - G1, G2 : Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Në Euro

		2019	2020	Total
1	Të Ardhurat e lejuara			
2	Të ardhurat nga shitja e ngrohjes	3,382,535.13	3,877,349.18	7,259,884.30
41100	Të ardhurat nga shërbimet e ngrohjes - Sektori Banesor	1,422,450.44	1,991,430.61	3,413,881.05
41110	Të ardhurat nga shërbimet e ngrohjes - Sektori Afarist	371,113.01	519,558.21	890,671.22
41120	Të ardhurat nga shërbimet e ngrohjes - Institucional	973,471.68	1,362,860.35	2,336,332.03
43000	Zbritjet gjatë faturimit/Mungesa e ngrohjes	-	-	-
42000	Të ardhurat nga shpenzimet e pa-autorizuara të energjisë	1,000.00	3,500.00	4,500.00
41125	Të hyrat nga inkasimet e borxheve të keqia	614,500.00	-	614,500.00
3	Të ardhurat tjera të lejuara	50,450.00	44,050.00	94,500.00
41140	Të ardhurat nga kyqjet (ç'kyqjet) e ngrohjes	42,000.00	43,500.00	85,500.00
41150	Të hyrat nga shtija e mbeturinave	13,000.00	4,500.00	17,500.00
45000	Të ardhurat nga shërbimet tjera	4,300.00	11,900.00	16,200.00
45100	Të hyrat nga taksat gjyqësore	1,550.00	4,050.00	5,600.00
44000	Interesi-Kamata	-	-	-
41130	Të ardhurat nga rrjeti sekondar	8,500.00	12,700.00	21,200.00
43100	Zbritjet e lejuara nga faturimi	(18,900.00)	(32,600.00)	(51,500.00)
4	Totali i të ardhurave të lejuara	3,432,985.13	3,921,399.18	7,354,384.30
5	Shpenzimet e lejuara			
6	Shpenzimet Operacionale			
7	Nga kjo: Shpenzimet variabile			
8	këtu hyjnë: Karburanti	502,102.00	1,022,242.80	1,524,344.80
50300	Energjia termike	501,602.00	702,242.80	1,203,844.80
50001	Nafta për prodhim	500.00	500.00	1,000.00
50000	Mazuti për prodhim	-	319,500.00	319,500.00
60500	Shpenzimet për raport të analizave të mazutit	-	-	-
9	Uji i trajtuar	51,972.18	42,725.55	94,697.73
50100	Shpenzimet e ujit	51,972.18	42,725.55	94,697.73
10	Kemikalet për trajtimin e ujit	14,656.02	565.60	15,221.62
	Kemikalet	14,656.02	565.60	15,221.62
11	Elektriciteti	224,575.20	371,913.95	596,489.15
50200	Shpenzimet e energjisë elektrike (Prodhim)	144,855.98	235,737.92	380,593.89
50201	Shpenzimet e energjisë elektrike (Nënstacione)	79,719.22	136,176.03	215,895.26
12	Shpenzimet e Personelit (puna direkte në prodhim)	244,509.62	733,528.86	978,038.48
71200	Prodhimi	73,399.72	220,199.15	293,598.87
71200	Distribuimi	171,109.90	513,329.71	684,439.61
13	Shpenzimet tjera variabile			
14	Totali i shpenzimeve variabile	1,037,815.01	2,170,976.76	3,208,791.77
15	Shpenzimet fikse			
16	këtu hyjnë: Riparimet dhe mirëmbajtja	41,650.00	125,950.00	167,600.00
70500	Shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve	2,000.00	8,000.00	10,000.00
70300	Shpenzimet për mirëmbajtjen e automjeteve	2,100.00	6,300.00	8,400.00
70200	Shpenzimet për mirëmbajtjen e kompjut. dhe pajisjeve tjera	525.00	1,575.00	2,100.00
70400	Shpenzimet për mirëmbajtjen e objekteve	9,187.50	27,562.50	36,750.00
70600	Shpenzimet për mirëmbajtjen e oborrit	262.50	787.50	1,050.00
70700	Shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike	2,493.75	7,481.25	9,975.00
70800	Shpenzimet për mirëmbajtjen e programeve softverike	1,575.00	4,725.00	6,300.00
	Shpenzimet për mirëmbajtjen e inventarit	2,100.00	6,300.00	8,400.00
61500	Shpenzimet e sigurimeve të objektit	-	-	-
60200	Shpenzimet për vendosjen e gypave	2,231.25	6,693.75	8,925.00

71400	Shpenzimet për leje për gropim	262.50	787.50	1,050.00
60301	Shpenzimet e sigurimit të automjeteve	-	-	-
60300	Regjistrimi i automjeteve	1,968.75	5,906.25	7,875.00
60302	Shpenzimet e kontrolles teknik	-	-	-
60303	Shpenzimet për taksat rugore	-	-	-
60800	Shpenzimet e taksave komunale	-	-	-
60000	Shpenzimet për punimin e pushtetave	10,000.00	15,000.00	25,000.00
60001	Shpenzimet për pastrimin e pushtetave	250.00	750.00	1,000.00
76000	Shpenzimet për mbrojtje kundër zjarrit	-	6,000.00	6,000.00
60100	Shpenzimet për rregullimin e rrugëve të dëmtuara	6,431.25	19,293.75	25,725.00
70100	Shpenzimet për servisimin e pompave	-	2,000.00	2,000.00
62000	Shpenzimet për bazhadrinim e peshores	-	1,000.00	1,000.00
62100	Shpenzimet për bazhadrinim e valvolave	-	5,000.00	5,000.00
70000	Shpenzimet për mirembajtjen e flakeruesve	262.50	787.50	1,050.00
17	Materialet dhe shërbimet	38,250.00	77,750.00	116,000.00
61200	Shpenzimet materiale të mirëmbajtjes	25,000.00	50,000.00	75,000.00
61250	Shpenzimet e materialit elektrik	8,000.00	12,000.00	20,000.00
61300	Shpenzimet e materialit zyrtar	5,250.00	15,750.00	21,000.00
18	Shpenzimet për administratë	27,772.50	83,317.50	111,090.00
74100	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar	5,250.00	15,750.00	21,000.00
74200	Shpenzimet për ekskurzion	-	-	-
75200	Shpenzimet e byfësë	525.00	1,575.00	2,100.00
61330	Shpenzimet për hixhienë	1,050.00	3,150.00	4,200.00
75300	Shpenzimet për larje të automjeteve	262.50	787.50	1,050.00
78000	Shpenzimet e derivateve	-	-	-
74000	Shpenzimet e reprezentacionit	2,625.00	7,875.00	10,500.00
79100	Shpenzimet për avokat	1,050.00	3,150.00	4,200.00
79150	Shpenzimet e permbarimit	6,562.50	19,687.50	26,250.00
71002	Shpenzimet për mbushje telefonike	2,887.50	8,662.50	11,550.00
71001	Shpenzimet e telefonisë mobile	472.50	1,417.50	1,890.00
71000	Shpenzimet e telefonisë fikse	262.50	787.50	1,050.00
72000	Shpenzimet e internetit	5,775.00	17,325.00	23,100.00
72500	Shpenzimet për mirëmbajtjen e web faqes	1,050.00	3,150.00	4,200.00
19	Shpenzimet e personelit	293,612.49	880,837.48	1,174,449.98
71200	Departamenti Administrativ	73,860.40	221,581.19	295,441.59
71200	Departamenti Financiar	35,426.76	106,280.29	141,707.05
71200	Pagat për Bordin e Drejtorve	14,217.01	42,651.02	56,868.02
71200	Termokos	49,480.75	148,442.25	197,923.00
71200	Departamenti i Prokurimit	7,561.26	22,683.79	30,245.05
71200	Zyra Mbështetëse	10,261.20	30,783.60	41,044.80
71200	Departamenti i Furnizimit	78,475.72	235,427.15	313,902.86
71200	Njesia për Projekte Zhvillimore	4,056.25	12,168.75	16,225.00
71200	Departamenti Ligjor	15,624.30	46,872.91	62,497.21
71200	Zyra e Auditimit	4,648.85	13,946.54	18,595.39
20	Shpenzimet e Shitjes dhe tjera Administrative	741,933.16	280,223.03	1,022,156.20
61600	Shpenzimet e provizioneve	600.00	1,800.00	2,400.00
61701	Shpenzimet e mbeturinave	525.00	1,575.00	2,100.00
63100	Shpenzimet për festa	2,625.00	7,875.00	10,500.00
64000	Shpenzimet për ndihma	-	-	-
71203	Shpenzimet e konsulencës	-	17,000.00	17,000.00
71300	Shpenzimet për tatimin në pronë	-	4,000.00	4,000.00
73000	Shpenzimet për taksat gjyqësore	656.25	1,968.75	2,625.00
79000	Shpenzimet e auditimit	-	3,000.00	3,000.00
73500	Shpenzimet për shpallje dhe njoftim	656.25	1,968.75	2,625.00
60700	Shpenzimet e kontributeve humanitare	1,837.50	5,512.50	6,990.00
63000	Shpenzimet tjera	787.50	2,362.50	3,150.00
61350	Shpenzimet për roba mbrojtëse	-	22,000.00	22,000.00
61100	Shpenzimet e ngritjes profesionale - trajnime	11,418.75	34,256.25	45,675.00
71201	Kontributet për sigurime pensionale (Pundhënësi)	26,906.11	80,718.32	107,624.42
	Shpenzimet e sigurimit shëndetësor			-
	Shpenzimet për licenca softverike	-	75,000.00	75,000.00
75100	Shpenzimet e promovimit të afarizmit	1,312.50	3,937.50	5,250.00

79200	Shpenzimet për taksën vjetore për liçencë (energjia termike nga kogjenerimi dhe prodhimi)	11,720.33	16,408.47	28,128.80
79400	Shpenzimet për anëtarim në OEK	-	1,200.00	1,200.00
79500	Shpenzimet për hulumtime	-	-	-
79900	Shpenzimet e provizioneve të Llogarive të Arkëtueshme	682,887.97	-	682,887.97
79800	Shpenzimet provizioneve të stoqeve	-	-	-
79700	Shpenzimet e provizioneve të rasteve gjyqesore	-	-	-
79950	Shpenzimet e provizioneve të kërkesave të ndryshme	-	-	-
89000	Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-	-
21	Totali i shpenzimeve fikse	1,143,218.16	1,448,078.02	2,591,296.17
22	Totali i shpenzimeve operative			
23	Zhvlerësimi	736,289.00	2,208,867.00	2,945,156.00
24	Totali i Shpenzimeve të Lejuara	2,917,322.17	5,827,921.77	8,745,243.94



Prishtinë, 04/09/2020

Përgjigjet në Komentet e ZRRE-së në Aplikacionin për Tarifa të NQ Termokos për sezonin 2020/2021

Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të veta ka filluar shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos për sezonin 2020/2021; në këtë aspekt me dt. 30 qershor 2020, NQ Termokos-it i është dërguar shkresa-njoftimi për fillimin e shqyrtimit tarifor për sezonin 2020/2021 dhe "Plani i zbatimit dhe orari". Në vijim, me 1 korrik 2020 NQ Termokos-it i është dërguar Kërkesa për të dhëna dhe informata për shqyrtimin tarifor, ku janë specifikuar të dhënat, informatat dhe dokumentet që NQ Termokos duhet të dorëzojë për shqyrtimin tarifor. Me 7 gusht 2020 NQ Termokos ka dërguar përmes e-mailit aplikacionin tarifor të pjesshëm me disa nga të dhënat dhe informatat e kërkuara. Ndërsa me dt. 12 gusht 2020, NQ Termokos ka dorëzuar të dhënat informata dhe dokumentacion shtesë në kuadër të aplikacionit tarifor për sezonin 2020/'21.

Në këtë dokument janë dhënë komente për përmbajtjen e aplikacionit për tarifa në përgjithësi, si dhe për përmbajtjen e secilit dokument të dërguar në kuadër të aplikacionit. Komentet kanë të bëjë me kompletimin / jo-kompletimin e aplikacionit, duke treguar se cilët dokumente janë dorëzuar dhe cilat do dureshin dorëzuar. Më tutje komentet elaborojnë në përgjithësi dhe japin udhëzime për korrektësinë e dokumenteve që përmban aplikacioni për tarifa, dhe gjithashtu, pas vlerësimit të secilit dokument të dërguar, kërkohen korrigjimet e nevojshme, informata dhe shpjegime shtesë.

Përmbajtja e Aplikacionit për Tarifa

Aplikacioni i tarifave i dorëzuar në formë elektronike nga NQ Termokos përmban këto dokumente:

- 1) Pasqyrat Rregullative me të dhënat dhe informatat e parashikuara për sezonin e ngrohjes 2020-2021:
 - a) Pasqyra A e asetëve operative – të dhënat e parashikuara për asetet fikse;
 - b) Pasqyra B e të ardhurave dhe shpenzimeve – të dhënat e parashikuara për të ardhurat dhe kostot (shpenzimet);
 - c) Pasqyra C e faturimit dhe arkëtimit – të dhënat dhe informatat për sipërfaqet e ngrohjes, kapacitetet dhe sasi të energjisë termike, faturimin dhe arkëtimin e konsumatorëve;
 - d) Pasqyra D e investimeve – të dhënat dhe informata për investimet kapitale të planifikuara;
 - e) Pasqyra E teknike - të dhënat e parashikuara për bilancin e energjisë termike, si dhe të dhënat teknike dhe të konsumatorëve (supozimet për kalkulimin e kërkesës reale për ngrohje, prodhimin dhe furnizimin e ngrohjes, dhe sipërfaqja ngrohëse e parashikuar).
- 2) Raporti i Auditorit dhe Pasqyrat financiare statutores për vitin 2019 – dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale:
 - a) Pasqyra e fitimit / humbjes (Bilanci i suksesit);
 - b) Bilanci i gjendjes;



- c) Pasqyra e rrjedhjes së parasë; dhe
 - d) Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.
- 3) Të dhënat dhe informatat tjera dhe dokumentet mbështetëse:
- a) Shpalosja (zbërthimet e detajuara) e pasqyrës B;
 - b) Planifikimin e prodhimit të energjisë termike nga kogjenerimi bazuar në parashikimin e kapaciteteve dhe sasisë së energjisë termike, si dhe të humbjeve përkatëse në rrjet; po ashtu edhe planifikimin e kostos së energjisë termike nga kogjenerimi.
 - c) Planifikimin e prodhimit të energjisë termike nga stabilimentet e prodhimit të ngrohjes së NQ Termokos, përfshirë edhe konsumin përkatës të lëndës djegëse – mazutit.
 - d) Planifikimet për sipërfaqen ngrohëse dhe konsumin e konsumatorëve për sezonin e ngrohjes 2020/21 bazuar në konsumin specifik të parallogaritur, si dhe humbjet në rrjet; gjithashtu edhe të dhënat të përmbledhura nga baza e konsumatorëve – numri i konsumatorëve, sipërfaqet ngrohëse dhe kapaciteti termik përkatës.
 - e) Planifikimet për kyçjet e reja për sezonin 2020/21;
 - f) Detaje dhe shpjegime për Investimet e planifikuara me vetë-financim dhe nga donacionet;
 - g) Lista e nënstacioneve - të dhënat për sipërfaqet ngrohëse dhe kapacitetet përkatëse, si dhe të dhënat tjera teknike (e dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale);
 - h) Lista e aseteve – të dhënat detale për asetet fikse ku janë dhënë vlera fillestare (e blerjes), zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme e aseteve (e dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale); dhe
 - i) Matjet e regjistruara për energjinë termike të prodhuar nga kogjenerimi (dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale);

Komente për Përmbajtjen e Aplikacionit të Tarifave

Aplikacioni i tarifave i dorëzuar nga NQ Termokos është mjaft i kompletuar dhe në përputhje me kërkesat e ZRRE-së. Përveq pasqyrave rregullative dhe pasqyrave financiare statusore janë dhënë edhe të dhëna, informata shtesë në formë të detajimeve dhe shpjegime shtesë për pozicionet kryesore të kostove operative dhe kapitale (investimeve), si dhe dokumente mbështetëse.

Komentet për secilin dokument të dorëzuar në ZRRE

- 1) Pasqyrat Rregullative me të dhënat dhe informatat e parashikuara për sezonin e ngrohjes 2020-2021:

- a) Pasqyra 'A' e aseteve operative – të dhënat e parashikuara për asetet fikse;

Në pasqyrën A janë paraqitur asetet në vlerën fillestare (kostoja e blerjes), është dhënë zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme (vlera neto kontabël). Gjithashtu asetet janë paraqitur të ndara sipas aktivitetëve të licencuara: prodhimi dhe shpërndarja e furnizimi, si dhe asetet e përbashkëta. Nga vlera fillestare (kostoja e blerjes) në vlerë totale 54,314,466 € është zbritur zhvlerësimi i akumuluar në vlerë prej 21,640,973 €, që rezulton në vlerë neto kontabël prej 32,673,493 €. Sidoqoftë ZRRE, do të bëjë llogaritjen e Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) bazuar dhe në përputhje me metodologjinë tarifore duke marrë parasysh RAB fillestarë, që paraqet RAB-in e realizuar në sezonin 2019/2020, dhe Investimet e planifikuara të arsyeshme dhe të lejuara në këtë shqyrtim tarifar.



Metodologjinë tarifore e bën ZRRE, andaj nuk kemi koment për këtë qështje. Poashtu pothuajse të gjitha investimet e planifikuara bëhen nga Departamentet e Distribimit, Prodhimit dhe Departamenti për Zhvillim dhe Investime Kapitale.

- b) Pasqyra 'B' e të hyrave dhe shpenzimeve – të dhënat e parashikuara për të hyrat dhe kostot.
- Të hyrat nga shitja e ngrohjes janë paraqitur në vlerë totale prej 7,259,884 €. Nga 'Shpalosja e pasqyrës B' vërehet se këtu përfshihen të hyrat nga faturimi për shërbimin e furnizimit me ngrohje në vlerë prej 6,640,884 €, e që përputhet me faturimin e planifikuar për shërbimin e furnizimit me ngrohje në Pasqyrë 'C'. Gjithashtu në këtë shumë janë paraparë edhe të hyra nga faturimi për shfrytëzimin e pa-autorizuar të ngrohjes në vlerë prej 4,500 € dhe nga arkëtimi i borxheve të vjetra 614,500 €. Lidhur me këtë duhet theksuar se arkëtimi i borxheve të vjetra (për sezonet paraprake) nuk trajtohet në llogaritjet përkatëse të të hyrave të lejuara për sezonin vijues.

• **Përgjigje nga Termokosi:**

- Këto të hyra kalkulohen duke aplikuar standardet e kontabilitetit. Por marrë parasysh se ZRRE nuk pranon as shpenzimet e provizioneve (përtej shumës së pranuar nga ZRRE), atëherë kjo e hyrë dhe shpenzimi relevant eliminonjë njëra tjetrën.

- Për koston e energjisë termike nga kogjenerimi është paraqitur shuma prej 1,204,845 €. Gjithashtu kjo kosto e parashikuar është llogaritur në planifikimin e koston së energjisë termike nga kogjenerimi (nën 'b') duke u bazuar në kapacitetet dhe sasitë e planifikuara të energjisë termike nga kogjenerimi dhe çmimet përkatëse, ku është llogaritur një vlerë tjetër – 1,230,610 €. Nga analizimi i kësaj kostoje dhe detajeve të ofruara është vërejtur se kjo kosto afërsisht korrespondon me sasinë e planifikuar të energjisë termike të ekstraktuar nga kogjenerimi dhe çmimet përkatëse për sasi të energjisë dhe kapacitet. Mirëpo, nga llogaritjet tona bazuar në kapacitetin e rezervuar dhe sasinë e energjisë termike sipas çmimit aktual rezulton se kjo vlerë është 1,267,020 €, pra është më e madhe se sa vlera e paraqitur në Pasqyrën 'B' respektivisht në llogaritjen e juaj të koston së energjisë termike nga kogjenerimi. Kërkohej shpjegimi përkatës respektivisht korrigjimet e duhura në paraqitjen e kësaj kostoje.

Përgjigje nga Termokosi:

- Kostoja e parashikuar për energjinë termike nga kogjenerimi në vlerë prej 1,230,610 €, është llogaritur bazuar në tarifat e fundit për energji termike, ku çmimi për kapacitet është 20.65€, ndërsa çmimi për energji termike është 1.35€. Gjithashtu në këtë kosto është përfshirë edhe taksa vjetore e licencimit (për energjinë termike nga kogjenerimi) prej 0.10€ / MW.
- Ndërsa vetëm kostoja e energjisë termike nga kogjenerimi është 1,203,845€, duke mos e përfshirë :
- Komponentën e pagesës për taksën vjetore të licencimit për energjinë termike nga kogjenerimi; 26,764.80euro, dhe
 - Komponentën e pagesës për taksën vjetore për prodhimin e energjisë termike nga mazuti; 1,364.00euro,



të cilat paraqiten ndaras nga kosto e energjise termike në Pasqyrat Rregullative.

- Gjatë shqyrtimit tuaj, ju keni kalkuluar me çmimet e sezonit të kaluar, të cilat në bazë të Aneks marrëveshjes në mes KEK dhe Termokos (të aprovuar nga ZRRE-së sipas Vendimit V 1192 2019), është bërë kompenzimi i sasisë së energjisë elektrike të shpenzuar në HES, sipas së cilës, çmimi për energji termike ka qenë 1.39€ /MWh, ndërsa çmimi për kapacitetin elektrik ka qenë 21.28€/MWh/h. Këto tarifa kanë vlejtur për periudhën nga 15.10.2019 deri 15.04.2020.
- Në Pasqyrë 'B' ju nuk keni paraqitur koston e prodhimit vetanak të energjisë termike nga kaldajat në ngrohtore respektivisht koston e lëndës djegëse (karburantit); përderisa keni dhënë llogaritjen e konsumit të mazutit për një periudhë 10 ditëshe (pika 'c') sipas rezervave të mazutit (sasia e shfrytëzueshme 710 ton). Duhet të paraqitni koston e prodhimit vetanak bazuar në konsumin e parashikuar të mazutit dhe çmimin e blerjes.
- **Përgjigje nga Termokosi:**
- Bashkangjitur në e-mail në Pasqyrat Rregullative- është bërë korrigjimi. (Këtë nuk e kemi njohur si shpenzim për arsye se e kemi vendosur si shpenzim që nga viti 2015 dhe asnjëherë nuk është realizuar).
- Për koston e elektricitetit është paraqitur kostoja prej 596,489 €, e që paraqet një rritje të prej afërsisht 60,000 € në krahasim me koston e realizuar sezonin e kaluar (537,378 €). Për këtë rritje të koston së paraqitur nga ju është e nevojshme të ofroni arsyetimin dhe shpjegimin për një rritje të tillë.
- **Përgjigje nga Termokosi:**

Planifikimi i zgjerimit të rrjetit – nënstationet e reja (21 nënstatione), planifikimi i rritjes së konsumit të energjisë termike që reflekton në rritjen e ngarkesës së pompave, ka ndikuar që të planifikojmë një rritje të konsumit të energjisë elektrike për 11% krahasuar me sezonin e kaluar.
- Për koston e personelit në administratë dhe shërbimet tjera është paraqitur vlera e planifikuar prej 1,174,450 €, pra është paraparë një rritje prej rreth 302,500 € nga vlera e realizuar në sezonin e kaluar 2019/20(871,930 €). Po ashtu rritje e dukshme rreth 55,000 € mes planifikimit dhe realizimit në sezonin e kaluar vërehet edhe për koston e personelit të prodhimit dhe shpërndarjes ('puna direkte'). Lidhur me koston e personelit po ashtu vërehet mos-përputhje e konsiderueshme në mes të vlerës së kësaj kostoje në Pasqyrat Rregullative të planifikuara (totali i koston së personelit: 2,152,488 €) dhe në Pasqyrat financiare statutores për vitin kalendarik 2019 (1,777,870 €); pra është një rritje prej mbi 370,000 €. Nevojitet të ofroni detaje për llogaritjen e kësaj kostoje duke dhënë numrin e punëtorëve, pagën



mesatare dhe elemente tjera të kostos së personelit, si p.sh. kontributet / taksat etj. Po ashtu duhet dhënë arsyetimet përkatëse për rritjen e parashikuar.

- **Përgjigje nga Termokosi:**

Sipas Skemës së re organizative të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, janë krijuar edhe dy departamente të reja të cilat duhet të plotësohen me staf : Departamenti Ligjor – edhe pse një pjesë është mbuluar me stafin ekzistues, duhet të plotësohet ende me staf të ri. Ndërsa Departamenti për Investime Kapitale (Njësi për zhvillime kapitale) ende nuk është plotësuar me stafin e paraparë. Gjithashtu, në D. e Distribimit dhe D. e Prodhimit ,bazuar në skemën e re organizative dhe për shkak të zgjerimit të rrjetit në lagjen Kalabria dhe Mati 1, është i domosdoshëm p lotësimi i vendeve të lira me kuadrot e nevojshëm .

- Për pozicionet e kostove: ‘Mirëmbajtja dhe riparimet’ dhe ‘Materialet dhe shërbimet’ ju keni paraqitur parashikimet prej 167,600 € respektivisht 116,000 €. Këto vlera të planifikuara janë dukshëm më të mëdha se sa realizimet e sezonit të kaluar 2019/2020 (45,644€ respektivisht 80,572€). Nevojitet shpjegim adekuat për arsyetimin e rritjes së planifikuar të këtyre kostove.

- **Përgjigje nga Termokosi:**

-Për pozicionin e kostos “Mirëmbajtja dhe riparimet”, si vlera më e theksuara janë:

-Kostoja për “Shpenzimet per mirëmbajtjen e objekteve “-kostoja 36,000.00 në të cilën janë paraparë rregullimi i 5 punkteve të reja për Departamentin e Distribimit(për shkak të zgjerimit të rrjetit), për të cilën janë paraparë 30,000.00euro. Ndërsa pjesa tjetër parashihet për mirëmbajtjen e rregullt.

- Kostoja për “Shërbimet për mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike” për të cilën janë paraparë - me fillimin e sezonit ngrohës, pritët të kemi nevojë për intervenim në pajisjet elektrike në HES dhe HRS.

-Për pozicionin “Shpenzimet për vendosjen e gypave” – për këtë pozicion janë planifikuar shpenzimet për depërtimin e gypave nën rrugë, nën objekte dhe në vendet ku nuk mund të intervenohet në mënyrë të rregullt. Megjithatë planifikohet të intervenohet në shumë pika ku instalimi i gypave në mënyrë të rregullt është i pamundur, duhet intervenuar në formën e depërtimit të gypave. Andaj planifikojmë që kostoja e paraqitur do të realizohet në periudhën raportuese.

- Për pozicionin “shpenzimet për rregullimin e rrugëve të dëmtuara”- për shkak se planifikohet të intervenohet në shumë pika ku do të ketë dëmtim të rrugëve , trotuareve , etj, pritët që kjo kosto të shpenzohet brenda periudhës raportuese.

-Për pozicionin e kostos “Materialet dhe shërbimet”,- duke pasur parasysh realizimin e punimeve të cilat parashihet të kryhen, planifikohet të shpenzohet kostoja e paraparë.

- Nën pozicionin “Shpenzimet e shitjes dhe tjera administrative” është paraqitur një vlerë mjaft e madhe prej 1,020,792 €, dhe nga detajizimi vërehet se pjesa kryesore i takon nën-komponentës “shpenzimet e provizioneve të llogarive të arkëtueshme” në vlerë prej 682,888 €. Lidhur me këtë dëshirojmë t’ju vëmë në dijeni se, në përputhje me dispozitat e Rregullës për vendosjen e çmimeve të energjisë termike, ZRRE e përcakton / lejon një përqindje të arsyeshme të nivelit të borxheve të këqija. Gjithashtu vërehet një nën-komponentë “kontributet për sigurim pensional” ku është paraqitur një vlerë prej



107,624€, që ne konsiderojmë se i përket kostos së personelit. Ju lutem të konfirmoni gjetjet tona më lartë.

- **Përgjigje nga Termokosi:**

Për pjesën e shpenzimeve të provizioneve të llogarive të arkëtueshme ndërlidhet komenti më sipër që ka të bëjë me njohjen e të hyrave nga borxhet e këqija.

Kurse sa i përket kontributit për sigurim pensional, ajo është kosto e personelit (kontributi pensional prej 5% e pagës bruto që punëdhënsi është i obliguar të paguaj për punëtorin).

-
- c) Pasqyra 'C' e Faturimit dhe Arkëtimit – të dhënat e parashikuara për sipërfaqen e ngrohjes, faturimin dhe arkëtimin
 - Në Pasqyrën 'C' ju keni parashikuar një sipërfaqe ngrohëse totale prej 1,419,449 m²; në këtë sipërfaqe totale, sipërfaqja e konsumatorëve me matje merr pjesë me 413,987 m² ndërsa sipërfaqja e konsumatorëve pa matje është parashikuar të jetë 1,005,462 m².
 - Nga analiza e jonë është vërejtur se, sipërfaqja e përgjithshme e ngrohjes është planifikuar të rritet për 34,855 m² nga sezoni i kaluar, që nuk korrespondon me planifikimet e kyçjeve të reja (planifikuar: 69,711 m²). Ju lutem të ofroni shpjegimet e nevojshme për sa u tha më lartë, si dhe të bëni korrigjimet përkatëse.

Përgjigje nga Termokosi:

- Është fakt se planifikimi i kyçjeve të reja sipas listës së dërguar është 69,711 m², kurse e planifikuar për faturim në sezonën e ardhshme është sipërfaqja prej 34,855 m². Kjo diferencë është për arsye se nuk kyçen të gjitha këto objekte prej fillimit të sezonës ngrohëse (d.m.th nuk mund të faturohen prej fillimit të sezonës ngrohëse). Gjithashtu edhe nga përvoja e viteve të mëhershme edhe kur të kyçen të gjitha sipas listës së dërguar 69,711 m², një pjesë e madhe e kësaj sipërfaqe mbetet pasive për shkak se janë pronë e qytetarëve që jetojnë në diasporë (d.m.th nuk e shfrytëzojnë ngrohjen).
- Në përputhje me rritjen e parashikuar të sipërfaqes ngrohëse, në mënyrë të drejtë keni paraparë edhe rritjen e faturimit, si dhe gjithashtu edhe rritjen e nivelit të arkëtimit.
- d) Pasqyra 'D' e shpenzimeve investive – investimet kapitale të planifikuara
 - Investimet e planifikuara të paraqitura nga ju janë shoqëruar me shpjegimet përkatëse për mënyrën e financimit – d.m.th. me vetë-financim dhe nga donacionet. Vërehet se pjesa dërmuese e investimeve planifikohet të financohet nga donacionet e organizatave / institucioneve ndërkombëtare (Qeveria Gjermane përmes KfE dhe Qeveria e SHBA-ve përmes MCC) me një pjesëmarrje të vogël të vetëfinancimit nga ndërmarrja. Shpjegimet shoqëruesgjithashtu përmbajnë detaje tjera të projekteve investive të paraqitura dhe janë paraqitur vlerat që planifikohen për periudhën njëvjeçare që përfshinë shqyrtimi tarifar, si dhe gjendjen gjegjësisht fazat aktuale përgaditore të këtyre projekteve. Duhet theksuar se projektet e planifikuara për këtë sezonë vijuese janë të përfshira edhe në planin zhvillimor afatgjatë. Sidoqoftë, duke marr parasysh vonesat që kanë ndodhur në



të kaluarën në realizimin e këtyre projekteve, dhe me qëllim të përcaktimit sa më real të Bazës së Rregulluar të aseteve, nevojitet një qasje sa më realiste në planifikimin e realizimit të këtyre projekteve.

- **Përgjigje nga Termokosi:**

Duke pasur parasysh zhvillimet e gjertanishme, gjegjësisht fazat aktuale përgaditore të këtyre projekteve, planifikojmë që vlera e planifikuar për periudhën njëvjeçare që përfshinë shqyrtimi tarifar, do të realizohet.

- Sa i përket investimeve me vetë-financim keni parashikuar një vlerë mjaft të madhe prej 2,282,000 €. Në këtë vlerë totale komponentët kryesore janë investimet në pajisjet e prodhimit (257,000 €) dhe në rrjetin e shpërndarjes (630,000 €); ndërsa komponenta më e madhe i përket ndërtimit të objektit të zyrave qendrore (administratës) në vlerë të përgjithshme prej 1,350,000 €. Lidhur me këtë duhet theksuar se në monitorimin e realizimeve të periudhës (sezonit) të kaluar është konstatuar se investimet me vetë-financim janë realizuar vetëm 23.64% (nga 1,380,000 € të lejuara janë realizuar vetëm 326,206€). Sa i përket konkretisht investimit të lejuar për ndërtimin e objektit të administratës prej 530,000 € është realizuar 67,980 € (vetëm 12.83%). Për sa u përmond më lartë kërkojmë informata të detajuara dhe dëshmi për progresin e fazave përgaditore të këtyre projekteve investive, ashtu që këto planifikime të arsyetohen mjaftueshëm dhe të pranohen në shqyrtimin tarifar.

Përgjigje nga Termokosi:

- Sa i përket investimeve me vetë-financim për komponentët pajisjet e prodhimit (257,000 €) dhe në rrjetin e shpërndarjes (630,000 €), duhet theksuar se vlerën më të madhe të këtyre investimeve e përbëjnë komponentet :

1. Bashkfinancim me projektin IPA 2015 - Komisioni European-Furnizim me Valvola DN 500 , DN 600- në vlerë prej 250, 000 euro për të cilën siç ju kemi informuar: Aktiviteti i prokurimit, i zhvilluar në vitin 2019, është anuluar pasi të gjitha ofertat kanë qenë të papërgjegjshme. Ndërsa , aktualisht jemi në proces të ritenderimit për realizimin e këtij investimi, dhe po përpiqemi t'a realizojmë në periudhën e planifikuar.
2. Nënstacionet modulare -në vlerë prej 150,000 euro, gjithashtu edhe këtë investim planifikojmë që ta realizojmë në kohën e paraparë.
3. Pjesët rezervë për sistem të kogjenerimit - në vlerë prej 100,000 euro -megënëse periudha e garancionit për pajisjet e kogjenerimit ka kaluar, paraqitet domosdoshmëria për t'u furnizuar me pjesët rezervë. Prandaj këtë investim planifikojmë që t'a realizojmë në kohën e paraparë.
4. Gjithashtu edhe komponentet tjerë që janë planifikuar, kryesisht janë elemente- pajisje që për shkak të zgjerimit të rrjetit janë planifikuar në sasi më të mëdha, do të përpiqemi t'i realizojmë sipas planifikimit.

- e) Pasqyra teknike 'E' –të dhënat e parashikuara për bilancin e energjisë termike, si dhe të dhënat teknike dhe të konsumatorëve.

Përgjithësisht të dhënat e paraqitura në këtë pasqyrë mund të vlerësohen si parashikime reale dhe të bazuara të prodhimit të energjisë termike dhe të furnizimit gjegjësisht konsumit të energjisë termike. Këto parashikime reflektojnë përgjithësisht rritjen e paraparë të sipërfaqes ngrohëse dhe ofrimin e një furnizimi cilësor dhe të qëndrueshëm.

2) Raporti i Auditorit dhe Pasqyrat financiare statutores për vitin 2019

Pasqyrat financiare statutores për vitin 2019: “Pasqyra e pozitës financiare”, “Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse”, “Pasqyra e rrjedhjes së parasë dhe Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet”, janë të përfshira në Raportin e auditorëve të pavarur dhe të aprovuara nga menaxhmenti i ndërmarrjes dhe të nënshkruara nga zyrtarët kompetentë. Nuk ka ndonjë koment tjetër shtesë.

3) Dokumentet tjera mbështetëse:

- Planifikimi i investimeve – të dhëna dhe informata detaje për investimet kapitale të planifikuara në periudhën një vjeçare që përfshin sezonin 2019/2020. Në dokument janë dhënë ndarazi investimet e planifikuara me financim vetanak të ndara sipas departamenteve në vlerë totale prej 2,282,000 €, dhe nga donacionet në vlerë totale 7,100,000 €. Këto japin vlerë totale të investimeve të reja për periudhën në fjalë në vlerë 9,382,000 €; këto vlera të paraqitura përputhen plotësisht me vlerat përkatëse të paraqitura në Pasqyrën ‘D’ të investimeve. Gjithashtu janë dhënë detaje dhe përshkrime, si dhe shpjegime përkatëse lidhur projektet kryesore investive të financuara nga donatorët si kfw dhe MCC. Investimet e planifikuara të paraqitura janë në përputhje me Planin Zhvillimorë Afatgjatë. Xhema
- Në Investimet e reja me vetëfinancim, ndër tjera, është planifikuar edhe ndërtimi i ndërtesës të zyrës qendrore administrative të NQ Termokos në vlerë prej 1,350,000 €. Lidhur me këtë investim duhet theksuar se ky projekt është paraqitur si planifikim edhe në shqyrtimin e kaluar tarifor, porse ende nuk ka filluar realizimi i tij për shkak të vonesave të ndërlidhura me përcaktimin e lokacionit dhe procedurave administrativo-ligjore për marrjen e pëlqimit/kushteve ndërtimore-urbanistike si hapa paraprirës në zhvillimin e projektit detal dhe marrjen lejes ndërtimore. Në kuptim të planifikimit realist do duhej që ky investim të arsyetohet me dëshmi konkrete për progresin në kryerjen e këtyre procedurave dhe përgaditjes së projekteve/planeve përkatëse (projekti ideor, projekti detal ndërtimor etj.), e gjithashtu kjo të reflektoj edhe në paraqitjen vlerave financiare përkatëse. Sidoqoft vërejtjet / komentet e bëra për Pasqyrën ‘D’ për investimet vetanake (nën pikën ‘d’) vlejné edhe këtu.
- **Përgjigje nga Termokosi:**

➤ Përkitazi me Investimet e reja me vetëfinancim, konkretisht ndërtimi i ndërtesës të zyrës qendrore administrative të NQ Termokos për të cilën kemi planifikuar vlerën prej 1,350,000 €, si dëshmi të bashkangjitura në e-mail, ua dërgojmë :

- Kontratë për studim fizibiliteti (Vlerësim) i situacionit dhe objekteve të NP“Termokos”sh.a)- e realizuar më datë 30.10.2019 -vlera e kontratës –18,980.00euro

-Kontratën për Shërbime projektimi (Hartimi i Projektit Detal dhe Vlerësimi i situacionit dhe objekteve të NP“Termokos”sh.a) -e realizuar më datë 15.04.2020- vlera e kontratës – 49,000.00euro, (për realizimin e këtyre dy kontratave kemi raportuar në realizimet e sezonit 2019/20),

-Lejen mjedisore komunale -04 Nr.352/10-86799/20 , e lëshuar me datë 23.07.2020,

-Leja e ndërtimit- 05 Nr. 351/02-7558/20 e lëshuar me datë 30.07.2020,



- Foto sipas Projektit të objektit të ri administrativ.

Kopjen e dokumenteve të lartëcekura i gjeni të bashkangjitura në e-mail.

- Ndërsa sa i përket vlerave financiare përkatëse për periudhën raportuese (tetor 2020-tetor 2021) ku kemi paraparë 1,350,000.00euro për Ndërtimin e objektit të ri administrativ dhe Mbikqyrjen e ndëtimt të objektit, kemi planifikuar:

-Për Ndërtimin e objektit të ri administrativ kemi planifikuar koston prej 1,300,000.00 euro, ku si pako e përbashkët do të jetë "Ndërtimi i objektit të ri administrativ dhe Lirimi i hapësirës për ndërtimin e objektit të ri ", me ç'rast për lirin e hapësirës do të kryhen këto intervenime:

- ç 'vendosja e nënstacionit për pranimin e mazutit,

-rrënimi i objektit (punëtorja e axhustatorëve) dhe

-largimi (eliminimi) i dy rezervuarëve të mazutit.

- Kostoja prej 50, 000.00 euro është paraparë për Mbikqyrjen e ndërtimit të objektit.

Aktualisht është në procedurë shpallja e tenderit për Mbikqyrjen e ndërtimit të objektit dhe në ndërkohë do të vazhdohet me procedurat e përzgjedhjes së punëkryesit për ndërtimin e objektit.

- Investimet e reja nga donacionet janë kategorizuar sipas projekteve dhe donatorëve përkatës (Qeveria Gjermane përmes KfW, Qeveria e SHBA-së përmes MCC etj.), ku janë paraqitur detajet teknike dhe financiare për këto projekte; në këto investime, ndër tjera, është paraqitur edhe hartimi i Studimit të fizibilitetit për energjinë termike nga panelet solare, i cili financohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH-EBRD) dhe Banka Gjermane për Zhvillimi (KfW), në vlerë 100,000 €. Duke qenë se ky projekt është në fazën fillestare pregaditore (fazën studimore), dhe se duhet të kaloj nëpër faza tjera të zhvillimit të projektit që natyrisht marrin kohë, do të ishte e arsyeshme që të paraqiten në fazat e mëvonshme të progresit të projektit. Sidoqoft vërejtjet / komentet e bëra për Pasqyrën 'D' për investimet nga dionacionet (nën pikën 'd') vlejné edhe këtu.
- **Përgjigje nga Termokosi:**
 - Në rregull- Përmirësimet janë bërë në Pasqyrën Rregullative "D" .
- Planifikimet për kyçjet e reja për sezonin 2020/2021
 - Janë paraqitur të dhëna mjaft detaje të paraqitura në formë tabelare për planifikimet e kyçjeve të reja që përmbajnë të dhënat për vendndodhjen (lokacionin) e objekteve, sipërfaqet ngrohëse dhe kapacitetet termike respektive.
 - Sa i përket sipërfaqeve ngrohëse mund të vërehet se, sipërfaqja e objekteve që planifikohet të kyçen në sezonin 2020/2021 është 69,711 m². Përderisa në pasqyrën 'C'sipërfaqja e përgjithshme e ngrohjes është planifikuar të rritet për 34,855 m² nga sezoni i kaluar, që nuk korrespondon me planifikimet e kyçjeve të reja. Ju lutem të ofroni shpjegimet e nevojshme për sa u tha më lartë, si dhe të bëni korrigjimet përkatëse.

Përgjigje nga Termokosi:



➤ Vlenë përgjigja e njejtë si tek pika "c".

- Në llogaritjen e konsumit të parashikuar për sezonin 2020/21 ju keni përvetësuar konsumin specifik ($170.25 \text{ kWh}_{\text{TH}}/\text{m}^2/\text{sezonë}$) të njëjtë për të 2 grupet e konsumatorëve – shtëpiak dhe komercial e institucional. Duhet të theksojmë faktin që konsumi specifik i këtyre 2 grupeve të ndryshon për shkak të karakteristikave të objekteve që i shfrytëzojnë.

Përgjigje nga Termokosi:

- Tek llogaritja e konsumit të parashikuar për sezonin 2020/21, konsumin specifik për konsumatorët shtëpiak, e kemi përvetësuar ($160.5 \text{ kWh}_{\text{TH}}/\text{m}^2/\text{sezonë}$) dhe për konsumatorët komercial e institucional është përvetësuar ($180 \text{ kWh}_{\text{TH}}/\text{m}^2/\text{sezonë}$). Ndërkaq vlera totale prej ($170.25 \text{ kWh}_{\text{TH}}/\text{m}^2/\text{sezonë}$), paraqet vlerën mesatare të konsumit specifik.

- Planifikimi i prodhimit të energjisë termike, furnizimit dhe humbjeve në rrjet
 - Prodhimi i energjisë termike në tërësi është parashikuar të jetë nga stabilimentet e kogjenerimit në TC Kosova B, ku detajet janë paraqitur në formë tabelare për prodhimin e energjisë termike nga kogjenerimi bazuar në Bilancin e energjisë dhe në planifikimet përkatëse për pjesën e dytë të sezonin (janar – prill 2021). Është paraparë gjithashtu prodhimi i energjisë termike nga stabilimentet e prodhimit në Ngrohtore (prodhimi me mazut) për rastet e ndonjë ndërpreje eventuale të furnizimit nga kogjenerimi.
 - Sa i përket vlerësimeve për furnizimin dhe humbjet në rrjet, duhet pasur parasysh dhe duhet bazuar në planifikimet përkatëse në Bilancet vjetore dhe afatgjata të energjisë termike.

Përgjigje nga Termokosi:

Meqenëse në planifikimin e Bilancit vjetorë 2020 të energjisë termike , humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes janë paraqitur 6.7%, këtë parashikim e kemi bërë bazuar në humbjet e një sezoni më parë 2018/2019, ku humbjet në rrjetin e shpërndarjes kanë qenë 6.8%. Mirëpo në sezonin e fundit, humbjet e energjisë (ujit) janë rritur ndjeshëm, për këto arsye:

- Është zgjeruar rrjeti, dhe për të ka pasur testime hidraulike disa herë, dhe
- Pjesa sekondare e objekteve të reja dhe atyre ku janë ndërruar nënstationet, janë mbushur me ujë nga rrjeti primarë;

Prandaj, fakti që edhe në sezonin 2020/21 planifikohet zgjerimi i rrjetit, do të bëhen testime dhe nënstationet e reja do të mbushen me ujë nga rrjeti primarë, ka ndikuar që planifikimi i humbjeve të energjisë në rrjetin e shpërndarjes për sezonin 2020/21 ,të jetë më i lartë se në planifikimet e Bilancit vjetorë 2020 të energjisë termike. Ndërsa sa i përket Bilancit afatgjatë të energjisë termike, jemi shumë afër planifikimit.

Shënim:

Këto komente janë dhënë me qëllim të korrigjimit dhe kompletimit të aplikacionit për tarifa në përputhje me kërkesat specifike të paraqitura aty.

Përgatitur nga:

Departamenti i Energjisë Termike dhe Gazit (DETG)

Raportet e detajizuara për shqyrtimin tarifor – sezoni 2020/2021

Të nderuar,

N.P."Termokos"SH.a, ka përgaditur dokumentacionin, raportet me të dhëna dhe informatat e kërkuara nga ZRRE në kërkesën e datës 01.07.2020, në lidhje me fillimin e shqyrtimit të tarifave të energjisë termike për sezonin 2020/2021.

Përveç Pasqyrave Rregulative të plotësuar me të dhëna të planifikuara, Shpalosjes së Pasqyrës B dhe Të hyrave të shtyera (të cilat ua dërgojmë si dokumente të bashkangjitura) , në këtë dokument janë dhënë edhe detajizime e shpjegime përkatëse .

Bazuar në kërkesën në fjalë, në këtë dokument janë paraqitur :

1. Detaje për prodhimin e energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B dhe në ngrohtoren qëndrore të NP "Termokos"SH.A

1.1 Detaje për prodhimin e energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B

- Në tabelën 1. është paraqitur energjia termike e planifikuar dhe kostoja e energjisë termike për sezonin 2020/21. Vlerësimi është bërë bazuar në kapacitetin e deklaruar dhe energjinë termike e cila derivon nga ky kapacitet (Kapaciteti x 6.56). Në kosto është llogaritur edhe taksa vjetore për energjinë termike nga kogjenerimi.

**** Plani për vitin 2021 ende nuk është aprovuar nga KOST dhe MZHE!**

Energjia termike e planifikuar për sezonin 2020/ 2021

	Kapaciteti I deklaruar MWh/h	Energjia MWh TER	Vlera e faturës pa TVSH/€
Tetor 2020	2,500.00	16,400.00	75,405.00
Nentor 2020	6,500.00	42,640.00	196,053.00
Dhjetor 2020	8,000.00	52,480.00	241,296.00
Janar 2021	8,400.00	55,104.00	253,360.80
Shkurt 2021	6,800.00	44,608.00	205,101.60
Mars 2021	6,300.00	41,328.00	190,020.60
Prill 2021	2,300.00	15,088.00	69,372.60
Total :	40,800.00	267,648.00	1,230,609.60

Tabela 1. Energjia termike e planifikuar për sezonin 2020/ 2021

1.2 Planifikimi I prodhimit të energjisë termike nga stabilimentet e prodhimit në ngrohje

- Aktualisht sasia bruto e mazutit në të katër rezervuarët është 870 ton, kurse sasia neto (të shfrytëzueshme) janë 710 ton.
- Për sezonin 2020/2021, në rast të ndonjë pengese për furnizim me energji termike nga termocentrali "Kosova B", planifikohet që furnizimi me ngrohje të bëhet nga stabilimentet e prodhimit të energjisë termike në ngrohje.
- Për këtë qëllim janë planifikuar të shpenzohen 710 ton mazut, që mjaftojnë për furnizim në kohëzgjatje prej 10 ditësh, duke shpenzuar mesatarisht nga 72 ton mazut në ditë.

2. Planifikimi i sasisë së energjisë së liferuar te konsumatorët dhe humbjet e energjisë në sezonin 2020/2021

Në tabelën në vijim është pasqyruar planifikimi për furnizimin e konsumatorëve me energji termike / ngrohje, si dhe humbjet në rrjetin e transportit (TC Kosova B-NQ Termokos), vetkonsumi dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes.

Në këtë tabelë nuk është përfshirë planifikimi i prodhimit të energjisë në ngrohtore, pasi që ajo planifikohet vetëm për rastet emergjente.

PLANIFIKIMI I SASISË SË ENERGJISË DHE HUMBJEVE PËR SEZONIN 2020/2021									
SEZONI 2020/2021									
	Kapaciteti i deklaruar	Energjia termike	Energjia termike e pranuar nga KEK	Humbjet e energjisë në rrjetin e transportit	Konsumi vetanak	Energjia neto e futur në rrjetin e shpërndarjes	Energjia e liferuar te konsumatorët	Humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes	Humbjet
	MWh/h	MWh TER	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	%
Tetor 2020	2,500.00	16,400.00	16,072.00	328.00	60	16,012.00	14,650.98	1,361.02	
Nentor 2020	6,500.00	42,640.00	41,787.20	852.80	120	41,667.20	38,125.49	3,541.71	
Dhjetor 2020	8,000.00	52,480.00	51,430.40	1,049.60	135	51,295.40	46,935.29	4,360.11	
Janar 2021	8,400.00	55,104.00	54,001.92	1,102.08	160	53,841.92	49,265.36	4,576.56	
Shkurt 2021	6,800.00	44,608.00	43,715.84	892.16	140	43,575.84	39,871.89	3,703.95	
Mars 2021	6,300.00	41,328.00	40,501.44	826.56	110	40,391.44	36,958.17	3,433.27	
Prill 2021	2,300.00	15,088.00	14,786.24	301.76	62	14,724.24	13,472.68	1,251.56	
Total :	40,800.00	267,648.00	262,295.04	5,352.96	787.00	261,508.04	239,279.86	22,228.18	8.5

Tabelaz. Planifikimi i energjisë termike dhe humbjeve në rrjetin e transportit të energjisë dhe rrjetin e shpërndarjes së energjisë.

- Humbjet në rrjetin e transportit të energjisë, janë planifikuar të jenë 2%, ndërsa humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë planifikuar 8.5%

Sqarim :

Humbjet e energjisë (ujt) janë rritur ndjeshëm në sezonën e fundit për këto arsye:

- Eshte zgjeruar rrjeti dhe për të ka pasur testime hidraulike disa herë;
- Pjesa sekondare e objekteve të reja dhe atyre ku janë ndërruar nënstationet janë mbushur me ujë nga rrjeti primarë;
- Edhe në sezonat në vazhdim, intenca është që të gjitha sistemet sekondare të mbushen me ujë të zbutur, prandaj edhe "humbjet" e energjisë (ujt) do të jenë më të mëdha se sezonave të mëparshme.

3. Të dhëna të përmbledhura nga Baza e të dhënave të konsumatorëve

Në tabelën 3 , kemi paraqitur të dhënat aktuale për, numri e konsumatorëve, sipërfaqen ngrohëse dhe kapacitetin termik .

Numri aktual i konsumatorëve			
	Numri I konsumatorëve	Sipërfaqja /m ²	Kapaciteti termik /MW
Sektori Banesor	13,572.00	812,649.03	81.26
Sektori Biznesor	1,150.00	80,273.49	11.24
Sektori Institucional	239	491,671.26	68.83
TOTAL	14,961.00	1,384,593.78	161.337

Tabela 3. Numri aktual i konsumatorëve, sipërfaqet respektive dhe kapaciteti termik

4. Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik për m² për vit, për sezonin 2020/2021

Në vijim, në mënyrë tabelare kemi paraqitur të përmbledhura, të dhënat për sipërfaqen, konsumin vjetor të energjisë dhe konsumin specifik vjetor, në varësi të llojit të konsumatorëve për sezonin e kaluar 2019/2020 dhe planifikimin për sezonin 2020/2021.

Sezona 2019/2020			
	Sipërfaqja m ²	Konsumi vjetor i energjisë MWh	Konsumi specifik kWh/m ² /vit
Konsumatorët shtëpiak	812,649.03	122,108.64	150.26
Konsumatorët Komercial dhe Institucional	571,944.75	97,802.55	171
Total	1,384,593.78	219,917.27	160.63

Tabela 4. Sipërfaqja ngrohëse, konsumi vjetor i energjisë dhe konsumi specifik për m² për vit, për sezonin 2019/2020

Planifikimi - Sezona 2020/2021			
	Sipërfaqja m ²	Konsumi vjetor i energjisë MWh	Konsumi specifik kWh/m ² /vit
Konsumatorët shtëpiak	831,842.36	133,510.70	160.5
Konsumatorët Komercial dhe Institucional	587,606.92	105,769.25	180
Total	1,419,449.28	239,279.94	170.25

Tabela 5. Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik për m² për vit, për sezonin 2020/2021

5. Planifikimi i kyçjeve të reja gjatë sezonit 2020/2021

Lidhur me planifikimin e kyçjeve të reja , në Tabelën 6, janë paraqitur detaje për planifikimin e kyçjeve të reja gjatë periudhës në fjalë, duke përfshirë lokacionin, numrin e konsumatorëve dhe sipërfaqet ngrohëse .

Objektet e paraqitura në këtë tabelë , janë planifikuar të kyçen gjatë sezonës ngrohëse 2020/2021, bazuar në realizimin e Projektit për zgjerimin e rrjetit nga Bashkimi Evropian dhe Termokosi.

PLANIFIKIMI I KYÇJEVE TË REJA GJATË SEZONËS NGROHËSE 2020/2021								
Objektet e planifikuara për kyçje		Laçja	Konsumatorët			Sipërfaqja m ²		
Nr.rend.	Objekti-Adresa	Laçja	Banesor	Afarist	Gjithësej	Banesor m ²	Afarist m	Gjithësej
1	Rr.Fadil Hoxha EXDC 4 ob.5 Hyr.93-Kalabri	Kalabri	14	7	21	1,251.00	1,703.00	2,954.00
2	Rr.Ymer Aliu,NN "Lesna Ndërtimi",Kompleksi "RIERA",Q.A-Kalabri	Kalabri	0	1	1	0	1,990.00	1,990.00
3	Rr.Ymer Aliu ,EUROPRINTV , Blloku A1-Hyr.95 (Hyr. 4),Hyr.103 (Hyr.5) sipas skicës)- Kalabri	Kalabri	39	1	40	2,792.61	3,120.29	5,912.89
4	Rr.Ymer Aliu "TED AF"-Petrit Deshishku Shpk ob.Z6,Z7,Z10,Z11,Z12-Kalabri	Kalabri	169	21	190	13,134.00	2,716.00	15,850.00
5	Taulantia A5 Hyr.1-2-3 (nr.i ri:50;48;46)-Ulpianë	Ulpianë	48	0	48	1,986.00	0	1,986.00
6	Taulantia A5 Hyr.4-5 (nr.i ri:44;42)-Ulpianë	Ulpianë	27	0	27	1,176.55	0	1,176.55

7	Taulantia A4 Hyr.1-2(nr.i ri:23;25)-Ulpianë	Ulpianë	31	0	31	1,380.00	0	1,380.00
8	Taulantia A4 Hyr.3-4(nr.i ri:27;29)-Ulpianë	Ulpianë	31	0	31	1,380.00	0	1,380.00
9	Taulantia C1 Hyr.1-2 (nr. i ri:40;38)-Ulpianë	Ulpianë	21	0	21	1,252.00	0	1,252.00
10	Ministria e Kulturës,Bul. "N.Tereza"-Qendër	Qendër	0	1	1	0	4,459.00	4,459.00
11	OPERA (Filharmonia e Kosovës,Sport Marketing;Bashkësia I Lokale-Qendër;Agjensioni për zhvillim Rajonal-Qendër)	Qendër	0	4	4	0	594.00	594.00
12	Teatri Kombëtar i Kosovës,Bul. "N.Tereza"-Qendër	Qendër	0	1	1	0	2,800.00	2,800.00
13	EULEX,Rr.Luan Haradinaj p.n-Qendër	Qendër	0	1	1	0	2,730.00	2,730.00
14	Qerdhja e FëmijëveRr.Perandori Justinian p.n-Qendër	Qendër	0	1	1	0	510.00	510.00
15	SHFMU "Meto Bajraktari",Rr.Josip Relap.n-Qendër	Qendër	0	1	1	0	5,126.00	5,126.00
16	Rr."B" Residjo 4 Hyr.A,B,C - Mati 1	Mati 1	95	31	126	7,680.20	3,252.14	10,932.34
17	Rr."B" Residjo 5 Hyr.A,B,C- Mati 1	Mati 1	74	23	97	6,354.30	2,323.91	8,678.21
Gjithësej			549	93	642	38,386.66	31,324.34	69,710.99

Tabela 6. Planifikimi I kyçjeve të reja gjatë sezonit 2020/2021

6. Planifikimi i Investimeve me vetfinancim

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur detaje për investimet- projektet , që planifikohet të realizohen me mjete vëtanake të N.P"Termokos"SH.A, gjatë periudhës tetor 2019/tetor 2020.

Investimet me mjete vetanake të Termokosit (tetor 2020- tetor 2021)		
Distribimi		
Përshkrimi	Periudha (tetor - dhjetor 2020)/ €	Periudha (janar -tetor 2021)/€
Gypa të paraizoluar		50,000.00
Këmbyes	10,000.00	25,000.00
Pompa qarkulluese	10,000.00	10,000.00
Valvola dhe Filtra	5000	20,000.00
Valvola rregulluese dhe matës energjie	5000.00	10,000.00
Ndërtim i pusetave dhe riparimi i rrugëve	15,000.00	25,000.00
Nënstacione modulare		150,000.00
Rehabilitimi i zyreve të rajonit të Distribuit	25,000.00	
Bashkfinancim me projektin IPA 2015 - Komisioni European-Furnizim me Valvola DN -500 , DN-600	250,000.00	
Plan ideor për studimin e fizibilitetit në Bregun e Diellit		20,000.00
Total	320,000.00	310,000.00
Total Distribui	630,000.00euro	

Prodhimi		
Përshkrimi	Periudha (tetor - dhjetor 2020)/ €	Periudha (janar -tetor 2021)/€
Pjesët rezervë për pompa të KSB		120,000.00
Këmbyes i nxehtësisë		35,000.00
Pjesët rezervë për Sistem të Kogjenerimit		100,000.00
Filtra		2,000.00
Total:		
Total Prodhimi :	257,000.00euro	
Administrata		
Përshkrimi	Periudha (tetor - dhjetor 2020)/ €	Periudha (janar -tetor 2021)/€
Ndërtimi i objektit administrativ	400,000.00	900,000.00
Mbikqyrja e ndërtimit të objektit Administrativ	20,000.00	30,000.00
Furnizimi me Kompjuter, Laptop dhe printera	20,000.00	25,000.00
Total :	440,000.00	955,000.00
Total Administrata :	1,395,000.00	
Total Investimet vetanake:2,280,000.00 euro		

Tabela 7. Planifikimi i Investimeve me vetfinancim

Sqarim lidhur me investimin "Bashkfinancim me projektin IPA 2015 - Komisioni European-Furnizim me Valvola DN -500 dhe DN-600", e cila ka qenë e planifikuar të realizohet gjatë periudhës tetor – dhjetor 2019:

- Aktiviteti i prokurimit, i zhvilluar në vitin 2019, është anuluar pasi të gjitha ofertat kanë qenë të papërgjegjshme. Ndërsa, aktualisht jemi në proces të ritenderimit për realizimin e këtij investimi.

7. Planifikimi i Investimeve nga Donacionet gjatë periudhës (tetor 2020-tetor 2021)

7.1. Planifikimi i Investimeve financuar nga Qeveria Gjermane – KfW për periudhën (tetor 2019- tetor 2020)

Informacione të përgjithshme

Për Projektin – Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetit, nga bashëpunimi i Qeverisë Gjermane përmes KfW, janë zotuar 14 milion euro dhe planifikohet të realizohet në periudhën 2019-2021.

Fondet e ndara për këtë projekt janë:

Qeveria Gjermane - 10 milion euro,
Qeveria Luksemburgut - 2.3 milion euro,
Komuna e Prishtinës - 1.7 milion euro

Total: 14 milion euro.

Detajet mbi dedikimin e fondeve:

- Për Konsulencë -2.5milion euro,
- Rehabilitim i rrjetit-1.5 milion euro (të cilat janë realizuar në vitin 2018 dhe në tremujorin e dytë të vitit 2019),
- Pjesa tjetër e fondit është dedikuar për :
 - Rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit,
 - Zgjerim dhe rehabilitim të termonënstacioneve,
 - Ndërtimin e rezervuarëve për deponim të ngrohjes.

Planifikimi i investimeve nga fondi i (Qeveria Gjermane përmes KfW) për periudhën (tetor 2019- tetor 2020)

Lidhur me projektin për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit, gjatë vitit 2019, është zgjedhur konsulencia "IC Consulanten" "Decon" dhe "CES" nga Austria. Projekti ende është në fazën e përzgjedhjes së kontraktorëve.

Konsulencia ka filluar punimet në përgatitjen e specifikimit teknik dhe procedurave për shpalljen e tenderit për zgjedhjen e kontraktorit për mbikqyrjen dhe ekzekutimin e punimeve.

Nga fondi i Qeverisë Gjermane përmes KfW (nga pjesa e mbetur e fondit në vlerë rreth 12 mil €), gjatë periudhës (tetor 2020-tetor 2021), planifikojmë të realizojmë shumën prej **5.5 milion euro**.

7.2 Planifikimi i investimeve financuar nga (Qeveria Amerikane - MCC) për periudhën (tetor 2020- tetor 2021)

Projekti për instalimin e matësve të energjisë - MCC

Përkritazi me këtë projekt, në tremujorin e dytë të vitit 2019, është zgjedhë konsulencia dhe kompania për mbikqyrjen e punimeve "IC Consulanten" nga Austria dhe "DECON" nga Gjermania.

Zhvillime të reja nuk ka pasur më, për shkak të rrethanave politike dhe çështjes së pandemisë.

Nga fondi prej 10,9 milion USD, I dedikuar për Projektin për instalimin e matësve të energjisë, gjatë periudhës (tetor 2020-tetor 2021), planifikojmë të realizojmë shumën prej **1.5 milion euro**.

Në tabelën në vijim ju paraqesim të përmbledhura investimet nga donacionet e paraqitura më lartë.

Planifikimi i investimeve nga donacionet për periudhën (tetor 2020- tetor 2021)			
	Donatori	Projekti	Vlera
1.	Qeveria Gjermane, Qeveria e Luksemburgut, K.E Prishtinës, përmes KfW	Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetit	5.5 milion euro
2.	Qeveria Amerikane - MCC	Instalimi i matësve të energjisë termike	1.5 milion euro
Total		7milion euro	

Tabela 8. Përmbledhje e investimeve të planifikuara nga donacionet